



Asdren Agushi
Pronar
NP "Radio Energji"
Nr. Biz: 80641745
Radio Shqip FM
R058
Gjilan

VENDIMI: LIC/KPM-2013/21
Ref: 1306/742/LIC/II

VENDIM

lidhur me ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit të Radio Shqip FM, Gjilan

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Shqip FM është subjekt transmetues me mbulim lokal, i cili më 12 mars 2010 është i pajisur me licencë afatgjatë të KPM-së, për të transmetuar radio programe në komunën e Gjilanit .
3. Më datën 14 mars 2013, pronari i Radio Shqip FM ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit, brenda qytetit të Gjilanit.
4. Më 26 mars 2013, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF), i Zyrës Ekzekutive të KPM-së, ka bërë matjet teknike për të vlerësuar parametrat teknik dhe mundësitë për kalim të sistemit të transmetimit të Radio Shqip FM, në pikën e propozuar për transmetim.

Arsyetimi

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se, KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
6. Rezultatet e matjeve, të bëra nga DMF, tregojnë se ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit të Radio Shqip FM, me transmetim nga pika transmetuese e propozuar mund të bëhet dhe nuk ndikon fare në ndryshimin e zonës së mbulimit, duke mos shkaktuar ndryshime në Tabelën Teknike të Licencës së KPM-së.


7. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së thekson se: *“përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së”*.
8. Prandaj, në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe 6.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM konstaton se, kërkesa e palës për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit brenda qytetit të Gjilanit, i përmbushë standardet e KPM-së për këto ndryshime të licencës së KPM-së.
9. Arsyetimin për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, KPM, e pranon si të mjaftueshëm dhe në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Me rastin e ndryshimit të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, Radio Shqip FM nuk e ndryshon kategorinë e subjektit transmetues, pra mbetet subjekt transmetues me mbulim lokal.

Vendim

11. Komisioni vendosë që Radio Shqip FM t'i lejohe ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit, sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.



Shefki Ukaj
Kryetar

Komisioni i Pavarur për Media



6 Shtator 2013

datë